



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA
PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 29573/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Mustafë Selimi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shqipe Hajdari, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Hoxha nga Prishtina. për kundërvajtje nga neni 7 par.1 lidhur me nenit 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e ne bazë të nenit 73,74,198 par.1 pika 8 si dhe nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më date 2.07.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Islam Hoxha, e lindur më 23.08.1973 në Gjakovë me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rr. "Pjetër Bogdani" pn, për kundërvajtjen nga neni 7 par.1 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, konformë nenit 198 par.1 pika 8 të LMK-së. në mungesë të provave.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtror gjykatës kërkesën nr.01/3267/2010, më dt.29.09.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Flutra Hoxha, dhe për kundërvajtjen nga neni 7 par.1 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen, dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Nr.regj.29573/2010, të pandehurën Flutra Hoxha e shpalli të fajshme... Sepse si zyrtare e Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër korrupsionit me rastin e marrjes së detyrës në afatin e caktuar ligjor dhe për këtë e njëjta është dënuar me gjobë në shumë prej 200 EU si dhe me të njëjtin vendim është obliguar ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 5 EU.

Kundër këtij aktvendimi më date 16.09.2011 e njëjta ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të qështjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe vendimit mbi dënimin.

Në bazë të ankesës së parashtruar Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë me aktvendimin "GJ.L" nr.1144/2011 të datës 27.09.2011, e Abrogon aktvendimin e shkallës së parë dhe lëndën e kthen në plotësim procedure si dhe në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes, në vështrim të nenit 227 të LMK-së, i mori të gjitha veprimet dhe i shqyrtoi të gjitha qështjet kontestuese të cilat i vuri në dukje Gjykata e Lartë për Kundërvajtje me rastin e Abrogimit të aktvendimit.

Nga vlerësimi me kujdes i të dhënave në kërkesën e parashtruar, deklarates së të pandehurës, e cila në tërësi e ka mohuar kundërvajtjen e cila i vehet në barrë, nga dëshmia e përfaqësuesit të autorizuar të AKK Afrim Atashi, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave tjera të deponuara në lëndë, Gjykata konstaton se e pandehura nuk e ka kryer kundërvajtjen ashtu siq e rëndon kërkesa. E njëjta nuk e ka pranuar personalisht kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës dhe nuk ka qenë e njohtuar lidhur me këtë obligim. Sapo ka pranuar shkresën nga Agjencia Kundër Korrupsionit se ndaj saj është inicuar procedure kundërvajtëse menjëherë e ka kryer këtë obligim ligjor për të cilën pranë Gyykatës prezantoi prova, andaj në vështrim të nenit 198 al.1 pika 8 të LMK-së Gjykata e Pezulloi procedurën dhe të pandehurën Flutra Hoxha e liroi nga përgjegjësia.


Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat të kësaj kërkesë, prej ditës se marrjes së këtij aktvendimi nepërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDIM I GJYKATËS KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

KRYETARI I GJYKATËS

Mustafë Selimi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Nr. Pril.	
Dep. <u>DPK/DMP</u>	Baz. Nr. <u>03-2670/12</u>
Nr. i faq.	Date
Broj stranica <u>01</u>	Date <u>30.07.2012</u>
Nr. pages	
PRISHTINË	